



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12, 14, 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 qershor 2008, dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, në mbledhjen e mbajtur me datë ____ 2026 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR KLUB TË FUTBOLLIT NË ZK-BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për klub të futbollit në njësinë kadastrale P-71409059-00559-8 të pjesës së sipërfaqes prej 20000m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 52200m² në vendin e quajtur "Balkan" evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.953/2026, tokës-pasuri shoqërore e KK-Lipjan në ZK-Babush i Muhaxherëve.

Neni 2

Caktimi (ndarja) e sipërfaqes ashtu siç u cek në nenin 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të promovimit dhe masivizimit të sportit të futbollit për të gjitha moshat.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Prandaj duke marrë parasysh kërkesat dhe arsyeshmerit për krijimin e kushteve me qëllim të promovimit dhe masivizimit të sportit të futbollit për të gjitha moshat, caktohet lokacioni për klub të futbollit, në njësinë kadastrale P-71409059-00559-8 të pjesës së sipërfaqes prej 20000m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 52200m² në vendin 'e quajtur "Balkan" evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.953/2026, tokës-pasuri shoqërore e KK-Lipjan në ZK-Babush i Muhaxherëve.

Prandaj duke u bazuar në dispozitat ligjore, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për arsim dhe edukim më të avancuar dhe interesit publik, kërkojmë nga kuvendi komunal miratimin e këtij propozim-vendimi.

Shtojcë:

- Certifikata e pronësisë Nr.953/2026 datë 19.03.2026, në ZK- Babush i Muhaxherëve

INr. 353/01-13298

Datë: 19.03.2026

Kryetari i Komunës

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës

Republika Kosovo–Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409059-00559-8

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

953/2026

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

19.03.2026 - 14:28

Komuna / Opština / Municipality:

LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Babush I Muhaxherëve / Muhadžer Babuš / Babushi I Muhagjerve

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409059-00559-8	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shogëitore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	52200	ndarje fiz. lf. 1/2016 ndarje fiz. lf. 2/2019 kor. kult.sip. kcid ak. kad nr. 123-0807-21	20.09.2021	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan	Azhuruar Ažurirano Updated
BALKAN	0		20.09.2021	

A.2.LLOJTI SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Pojloprivredno/Agriculture	Kulllosat/Pasnjaci/pasture	Kulllosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klasse/4th Class Pasture	52200

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	///		SHQIPËRIA	1/1		22.09.2021